



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 192/9 Prot.

Tiranë, më 02.06.2020

V E N D I M

Nr.36, datë 02.06.2020

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË
LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL NË INSTITUCIONIN
QENDRA KOMBËTARE E EDUKIMIT NË VAZHDIM DHE PARALAJMËRIMIN E
INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR GJENDJEN E LIGJSHMËRISË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, të miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,

VËREJ SE:

Me vendimin nr. 19, datë 13.2.2020, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Objekti i mbikëqyrjes përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit

civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes me nr. 192/1 prot., datë 13.2.2020, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili i është njoftuar subjektit me shkresën nr. 192/2, datë 13.2.2020, “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim”.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 192/5 prot., datë 6.5.2020, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Me shkresat nr. 192/6 prot., datë 6.5.2020 dhe nr. 192/7 prot., datë 6.5.2020, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim, institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, projektraporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje, respektivisht, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që është ministria nga e cila varet institucioni i mbikëqyrur dhe Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për institucionin e mbikëqyrur.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës, me shkresën nr. 85/3 prot., datë 11.5.2020, “Kthim përgjigje”, ka dërguar projektraportin e nënshkruar nga personat përgjegjës pa bërë vërejtje, në lidhje me gjetjet e grupit të punës të pasqyruara në të.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, referuar seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Departamenti i Administratës Publike, në mbështetje të kompetencave të tij, të parashikuara në nenin 7, pika 2/b e 2/ç, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe me Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, me qëllim që të rregullohet situata e administrimit të shërbimit civil, duhet të marrë masat, për të materializuar ndryshimet përkatëse në aktin nënligjor të krijimit të institucionit, në lidhje me marrëdhënien e punësimit për nëpunësit civil të këtij institucioni, si dhe administrimin e shërbimit civil në tërësi.
3. Departamenti i Administratës Publike dhe institucioni i mbikëqyrur, të përfundojnë procesin e miratimit të përshkrimeve të punës, në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, siç parashikohet në pikën 19, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar.

Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse (DAP), një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkuara sipas dispozitës së mësipërme të bëhet pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil, si dhe një kopje të depozitohet në arkivin e institucionit.

4. Të anulohen aktet administrative që kanë dalë në kundërshtim me ligjin, gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve të punës për 6 mujorin e dytë të vitit 2019, sipas detyrave të lëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe të fillojë procesi i vlerësimit nga e para.

Në respektim të procedurave të hollësishme të parashikuara në vendimin nr. 109, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar dhe lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi, nga nëpunësit përgjegjës duhet të përfundojë vlerësimi i rezultateve në punë të nëpunësve civilë, për 6 mujorin e dytë të vitit 2019, si dhe të respektohet procedura dhe afati edhe për 6 mujorin e parë të vitit 2020.

5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30** ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
6. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjatimit të nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
8. Për këtë vendim të njoftohet Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Departamenti i Administratës Publike.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha